



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Në bazë të nenit 17 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 15 të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe ansferte, nr. 01/111-400 të datës 28 maj 2012 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, si dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e buxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2019, nr. 01-400/-03-0078667/18, datë 26.09.2018, bën:

FTESË PUBLIKE

Për aplikim në projektin:

➤ Përkrahja me shoqëri bletësh

(Projekti do të realizohet në bashkëpunim me përfituesit)

Subvencionimi në projektin e cekur realizohet përmes formës së participimit financiar nga ana e bletarëve -fermerëve- përfitues.

Bletarët-fermerët përfitues do të marrin pjesë me **30%** të vlerës së projektit.

Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me **70%** të vlerës së projektit.

Bletarët-fermerët përfitues para lidhjes së kontratës do të paguajnë **30%** të vlerës së kontratës në llogarinë bankare të Komunës.

Përfitues : 100 bletarë me nga 10 shoqëri bletësh

KUSHTET PËR APLIKIM

- Të jetë banorë i Komunës së Podujevës (kopja e letërnjoftimit)
- Vërtetimi i tatimit në pronë
- Të ketë së paku 10 shoqëri bletësh
- Të jetë i trajnuar në lëmin e bletarisë
- Përparësi kanë bletarët – fermerët të cilët nuk kanë përfituar në projekt të Komunës

- Afati i aplikimit: nga data 08.04.2019 deri më 19.04.2019
- Aplikacionet dorëzohen në Qendrën e shërbimit për qytetarë, objekti i Komunë, zyra nr.14

Nr.prot.12-320/01-0030346/19
Podujevë, 08.04 2019



Drejtori
Vezir Januzi